Kronikë

Qarkullonte me pistoletë në makinë në zonën e ish-Bllokut! Shoqërohet në komisariat Erik Fullani! Policia: Punon si bodyguard, armën e kishte me leje

Një 29 vjeçar është shoqëruar nga policia e Tiranës ditën e sotme në zonën e ish Bllokut. Mësohet se bëhet fjalë për të riun, Erik Fullanin, djali i ish guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani.

Erik Fullani

Redaksia
20 Shkurt, 16:25 | **Përditësimi: 20 Shkurt, 16:45**

Një 29 vjeçar është shoqëruar nga policia e Tiranës ditën e sotme në zonën e ish Bllokut. Mësohet se bëhet fjalë për të riun, Erik Fullanin, djali i ish guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani.

Sipas njoftimit të policisë, Fullani u ndalua nga policia për t'u gjobitur me 20 mijë lekë të reja për xhamat e errësuara të makinës së tij. Gjatë kontrollit të bërë në automjetin e tij, policia gjeti edhe një armë zjarri.

LEXO EDHE:
Asfaltohet rruga pas Bankës së Shqipërisë/ Veliaj: Unaza e vogël' me tapet të rë; Terminal për urbanët pas Teatrit të Operas dhe Baletit

Pas shoqërimit në komisariatin nr.2 dhe verifikimeve të bëra, rezultoi se arma e gjetur në makinën e Erik Fullanit ishte me leje pasi ky i fundit punon si truprojë (bodyguard) në një firmë private. Në vijim të veprimeve arma u dorëzua tek drejtuesi teknik i firmës.

Erik Fullani është mjaft i njohur edhe në rrjetet sociale ku prej vitesh reklamon jetën e tij luksoze mes makinave të shtrenjta.

B.V/Shqiptarja.com

TAG: Tirane policia e tiranes erik fullani

Komento

Komente

Iris: 21/02/2023 01:57

Uau,i biri i guvernatorit te bankes kombetare na paska perfunduar truproje?! Kam respekt per truprojet se kane pune /me koke ne torbe/ thote popullj,por kete e prisnim te behej drejtor,ose dicka e tille,sepse te gjithe femijet e ketyre lloj yvtarieve vetem per drejtora,profesora/ZVL0 ministrie/ e seksere gjykate i ke,cdo pune tjeter u prish /dockat/ e buta dhe u lodh kurrizin.Dhe sa per armen,a nuk duhej t'a dorezonte ne mbarim te orarit te punes tek eprori?!

Përgjigju

Gimi: 20/02/2023 21:47

Shtetin e Kane kapur horrat dhe bespereet tash e 30 vjet kot lodheni me komente,

Përgjigju

Gripi: 20/02/2023 19:42

A ka ndonje fije morali Policia e Shtetit kur jep leje arme? Lejet i leshon Policia e Shtetit dhe jo firma private. Kush ka verifikuar informacionin dhe kush ka firmosur per ate leje duhet te shkarkohet urgjentisht. Firmes ti hiqet licensa dhe drejtuesi teknik te procedohet penalisht. Por kur nuk funksionon shteti do na duhet te vetembrohemi nga horrat dhe bijte e horrave.

Përgjigju

Emigranti: 20/02/2023 23:46

Koment me vend Gripi. Policia me barkderret e zinxhirit komandues jan fajtore qe bijt e bukur te baballareve te pasur bejn vetem probleme rrugeve. Ishallah hasin ne ndonje qe jua tregon vendin e duhur!!!!

Fadil: 20/02/2023 17:36

I paskan mbaru leket e bankes ketij!

Përgjigju

BSH: 20/02/2023 17:33

Po ky fshinte djerset me 500€, ku i hyn ne sy puna si bodyguard...

Përgjigju

Tirana: 20/02/2023 17:10

Na mbyten budallejt. Edhe i jati kedhtu eshte sjellur ne moshen e tij. Fullanesha ka xhepat plot... ku i moren ??

Përgjigju

Koci mina: 20/02/2023 16:51

Sa t ket babin ky fisi normale qe do dali bodyguard, ky ska ber pik sekonde pune ne jeten e tija na dalka bodyguard, ajde drejtesi ajde

Përgjigju

Fadil: 20/02/2023 19:24

Sa tket shok e miq kan per ta msu si tja hudhi bythës riku

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A e mbështesni strategjinë e protestave të opozitës?

PO JO NUK KAM MENDIM

Lajme të tjera

Tirana City Talks/ Veliaj: Tirana më e pastër se ç'e gjetëm, së shpejti linja të dedikuara për autobusët
20 Shkurt, 17:38

Vdekja e 22 vjeçares keniane muaj pasi u dhunua në Tiranë, qytetarët protestojnë para prokurorisë: Hetimet për të u neglizhuan vetëm sepse ishte me ngjyrë
20 Shkurt, 17:37

U rrëzua aksidentalisht pranë shtëpisë së tij, i moshuari nga Bulgjza dërgohet me helikopter drejt Tiranës
20 Shkurt, 16:50

Mjeku Pëllumb Pipero në luftë për jetën, shtrohet me urgjencë në spital
20 Shkurt, 13:45

Kërkoi masë më të lehtë sigurie, ish-zyrtarja Alda Klosi lihet në burg! Avokati: Apartamenti i sekuestruar në pronësi të ish burrit! S'ka pse të deklarojë paratë e vëllait
20 Shkurt, 10:06

Vodhën para dhe sende të ndryshme në 8 biznese në Tiranë me makinë luksoze, arrestohen 2 të rinjtë! Nën hetim 41-vjeçari
20 Shkurt, 09:53

VIDEOLAJM/ Timo Flloko 'kokë më kokë' me Kadarenë, aktori interpreton poezinë e njohur të shkrimtarit
19 Shkurt, 21:43

FOTOT/ 'Rosa Mandarinë' rosa e rrallë që është shfaqur në Liqenin artificial të Tiranës
19 Shkurt, 21:10

'E gjithë familja në taekwondo/Veliaj në eventin e veçantë sportiv: Investimi në sport, një nga vendimet më të mira që kemi marrë
19 Shkurt, 20:24

New York Times: Piramida e diktaturës, basti i së ardhmes së Shqipërisë
19 Shkurt, 20:11

Ende mister origjina e parave të Klosit! Ish-zyrtarja merret në pyetje në burg: Vetëm 120 mijë eurot janë të miat! Havier Dobi i qëndron dëshmisë së nënës
19 Shkurt, 18:59

Mbreti Zog vodhi më shumë ar gjatë largimit nga Shqipëria, Bido për Report Tv: Kam rezerva, Italia kishte interes t'i ekzagjeronte faktet për ta rrëzuar nga froni
19 Shkurt, 17:05

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje